



Të reja ▾Kush jemi ▾Historiku ▾Shërbime ▾Baza ligjore ▾Vendndodhjet ▾Video ▾Programi i transparencës ▾Kontakt

Denonco Krimin Kibernetik ▾Drejtoritë Vendore ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾Donacione ▾Policimi në Komunitet ▾

Përmbledhja Mujore ▾Për sinjalizimin ▾Të Guximshëm pa Armë

Breaking News:

Reagim i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan



Lajmet ▾Operacionet

31/07/2025

Vau i Dejës/Kapet 1 Shtetas.I Shpallur Në Kërkim Për Kultivim Të Bimëve Narkotike Në Fshatin Mnelë

Vau i Dejës/Vijojnë veprimet hetimore dhe operacionale në kuadër të operacionit policor antikanabis, të koduar “Koordinata”.

Kapet dhe vihet në pranga një 27-vjeçar, i cili ishte shpallur në kërkim pasi është identifikuar nga hetimet si autor i dyshuar i kultivimit të 180 bimëve narkotike Cannabis Sativa, në fshatin Mnelë.

Punohet për kapjen e një 17-vjeçari, bashkëpunëtor për kultivimin e këtyre bimëve narkotike, të cilat janë gjetur dhe asgjësuar nga shërbimet e Policisë, në muajin qeshor.

Procedohet në gjendje të lirë babai i 27-vjeçarit, pasi gjatë kontrollit në banesë iu gjet një armë gjahu që e mbante pa leje.

Në vijim të veprimeve hetimore dhe operacionale në kuadër të operacionit policor antikanabis, të koduar “Koordinata”, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Vau i Dejës kapën dhe ndaluan shtetasin P. N., 27 vjeç. Ky shtetas ishte shpallur në kërkim pasi nga hetimet e kryera me metoda proaktive, në drejtimin e Prokurorisë, dyshohet se një bashkëpunim me një 17-vjeçar, kanë kultivuar 180 bimë të dyshuara narkotike Cannabis Sativa, në fshatin Mnelë, të cilat janë janë gjetur dhe asgjësuar nga shërbimet e Policisë, në muajin qershor. Punohet për kapjen e 17-vjeçarit.

Në vijim të veprimeve procedurale, u krye kontroll në banesën e shtetasit Z. N., 62 vjeç, babai i shtetasit të arrestuar, ku u gjet dhe u sekuestrua një armë gjahu që 62-vjeçari e mbante pa leje. U referuan materialet procedurale në Prokurori dhe nisi procedimi penal për 62-vjeçarin.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për veprime të mëtejshme.
#angazhimpërkushtimsakrificë
#tëvendosurkundërkrimit ✓
#nëçdoskajtëvendit
#nëshërbimtëqytetarëve
#denonconë112

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Krujë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Inside”, kapet 1 shtetas në kërkim

Reagim i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan ▶